

**MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE
FATOS TUSHE**

SPRCIFIKIMET TEKNIKE

***Objekti “Sherbimi i gjelberimit ne Bashkine Lushnje
(njesia Lushnje dhe njesite administrative)”***

Realizimi sa me mire i sherbimit te mirembajtjes se siperfaqeve te gjelberta, drureve e shkurreve dekorative kerkon qe ky sherbim te jete i perditshem Per kete arsye punetoret e ketij sherbimi duhet te jene te perhershem dhe te palevizshem. Punetoret duhet te kryejne pastrimin e siperfaqeve inerte me fshesa, pastrimin e siperfaqeve te gjelberta dhe me lule nga mbetjet urbane prashitjen e drureve e shkurreve dekorative, bordures se gjelbert dhe siperfaqeve me lule, pastrimin nga barerat e keqija te siperfaqeve inerte, pastrimin e mbetjeve nga krasitjet e drureve dhe shkurreve dekorative etj. Subjekti realizon nje plan organizimi per shperndarjen e punetoreve per te kryer sherbimet perkatese.numri i punetoreve te perhershem eshte llogaritur ne tabelat perkatese per cdo muaj ne raport te drejte me volume e punes sezonale. Duke qene se sherbimi do te kryhet dhe ditet e djele dhe ne ditet e festave do te jete nje punetor zevendesues per punetoret qe do te punojne ne keto dite dhe per lejet e zakonshme.

Te gjitha punetoret do te jene te paisur me fshesat perkatese, krehera , sqepare te vegjel, kazma toke dhe duhet te jene te veshur me uniformen perkatese.

Subjekti do te realizoje dhe planin e lejeve te zakonshme qe i takon me ligj cdo punetori dhe ky plan nuk duhet te cenoje aspak nevojen e sherbimit te siperfaqeve te gjelberta.

A. SHERBIME TE THJESHTA DHE TE DOMOSDOSHME.

Pastrimi nga mbetjet i siperfaqeve te gjelberta

Ky sherbim kryhet cdo dite gjate gjitha vitit kalendarik duke perfshire edhe te dielat dhe ditet festive me punetor zevendesues

Pastrimi nga mbetjet i siperfaqeve te gjelberta do te kryhet ne te gjthe inventarin ne volume , siperfaqe rruge e sheshe, siperfaqe bari dhe siperfaqe te luleve

Pastrimi nga mbetjet i siperfaqeve te gjelberta dhe grumbullimi i tyre do te behet me fshesa te tipit industrial dhe transporti i tyre deri ne kontenier do te realizohet me karroca dore tip kosh ne ato siperfaqe qe jane me te medha kurse ne siperfaqet e vogla me mjete te thjeshta dore.

Ndalohen vendet e grumbullimit te mbetjeve per evadime te mevonshme ne territoret urbane te vendit. Cdo mbeturine e grumbulluar gjate procesit te punes nuk do te jete me shume se 10 m largesi nga vendet e pastrimit ne cdo moment. Ne siperfaqet e gjelberta jane perfshire edhe pastrimi e sistemimi i vaskave te shatervaneve dhe ujrave te pakten nje here ne jave por edhe me shume ne cdo rast eventual te mbindotjeve te tyre.

Ne kete ze do te kryhet edhe pastrimi me kreher qe do te realizohet kryesisht ne siperfaqet e barit dhe te luleve por do te realizohet edhe buze bordurave te gjelberta dhe siperfaqeve te tjera poshte drureve halor dhe ne ato siperfaqe te vogla qe nuk mund te pastrohen me fshesa.

Vaditja

Eshte proces kryesor mbas mbjelljeve te siperfaqeve te barit, te siperfaqeve te luleve, te drureve e shkurreve decorative dhe bordurave te gjelberta. Eshte i domosdoshem gjate periudhes se veres por edhe ne stine te tjera.

Vaditja e siperfaqeve te barit dhe te luleve do te realizohet me sistem vadites me inpiant perkates por edhe me markusha me dore, kryesisht gjate dites e nates dhe heret ne mengjes nga puset. Vaditja e drureve dekorative rrugor do te kryhet me ane te autoboteve dhe uji do te sigurohet nga puset ekzistues.

Vaditja do te realizohet ne cdo kohe nga punetoret ruajtes dhe mirembajtes te parcelave te cilet duhet te instruktohen mbi menyren e vaditjes se cdo lulishteje.



Prashitja dhe pastrimi i barit te keq.

Prashitjet jane operacione te tilla pune te domosdoshme jo vetem si nevojte biologjike por ato sherbejne edhe per rritjen e dekorit ne siperfaqet e gjelberta ne lulishte. Ne kete operacion pune futen te gjitha bimet e larta dhe te uleta (druret dhe shkurret dekorative, bordurat e gjelberta dhe siperfaqet me lule.

Prashitja nuk do te kryhet vetem gjate periudhave te ngricave ne muajt Dhjetor dhe Janar te cdo viti kalendarik kurse per te gjitha muajt e tjere ajo do te realizohet vazhdimisht sipas nevojave biologjike te bimeve dhe si nevojte e realizimit te dekorit te kerkuar e te percaktuar ne planet operative mujore.

Prashitja e siperfaqeve me lule do te kryhet 12 here ne cdo vit kalendarik.

Gjate prashitjes rreth bimeve dhe siperfaqeve me lule do te kryhet ne menyre te vazhdueshme pastrimi i barit te keq i cili demton ato dhe influencon negativisht ndaj dekorit te kerkuar.

Diametri i prashitjes dhe pastrimit te barit te keq nuk do te jete me i madh se 0.5-0.6 m ne cdo bime te larte dhe te ulet. Bari i keq do te largohet edhe ne siperfaqet e barit ne menyre te vazhdueshme ne cdo stine te vitit me mjete te thjeshta dore.

Punimi i vendeve te shkelura

Punimi i vendeve te shkelura realizohet ne siperfaqet e barit te cilat jane shkelur nga kalimtare.

Realizimi i ketij procesi pune behet per te rritur ne cdo kohe dekorin ne siperfaqet e lulishteve dhe per parandalimin e demtimeve nga kalimtare te ndryshem. Vendet e punuara ne siperfaqet e barit duhet te rrethohen me shirita kufizues dhe te vaditen me qellim mbirjen e barit te ri.

Ky process do te kryhet me kazem dore ne nje thellesi 15-20 cm. Volume i punimeve ne kete ze do te jete i pa kufizuar e rendesishme eshte qe ne siperfaqet e gjelberta te mos kete pjeseza te shkelura dhe te patrajtuara me qellim qe te ruhet dekori.

Kater operacionet e pershkuara me poshte qe do te kryhen nga punetoret ruajtes dhe mirembajtes cdo siperfaqe qe mbulohet nga ata garantojne standartet qe pershkuhen me poshte.

Standartet e siperfaqeve te gjelberta; para, gjate dhe pas sherbimeve te realizura ne cdo kohe.

Gjate zbatimit te punimeve dhe sherbimeve te gjelberimit duhet te kihet parasysh per njesine Lushnje :

Siperfaqe me lule: Ze nje siperfaqe 472 m² te punohet mire toka, nivelohet me niveluese, pasurohet me kimikate, hidhet fara e barit e cila duhet te jete e mire dhe e llojit te tille qe ti pershtatet kushteve klimaterike te zones sone. Pas mbirjes se fares duhet te kositet vazhdimisht qe te ruhet gjatesis prej 10 m.

Siperfaqe me bar : Ze nje siperfaqe prej 46 641 m² te cilat perfshijne blloqe banimi te ndryshme ne qytet ,ne sheshin e bashkise dhe ne lulishten ne qender te qytetit.Pas mbirjes se barit duhet te kositet dhe te mirembahet ne menyre periodike.

Bordure e gjelber: Ze nje siperfaqe 848.6ml duhet pasur kujdes i vecante ne mirembajtjen dhe zbururimin e kesaj pjese te projektit pai kjo bend he thyerjen e siperfaqes se gjelbert me asfaltin. Duhet te kete nderthurje te barit me lulet per te formuar dekoracione te ndryshme.

Drure dekorative dhe blerje drure dekorative: Numri i drureve dekorative ne blloqe banimi dhe rruge te qytetit ka nje numer prej 2463 rrenje dhe 186 rrenje te llojit palma.Mirembajtja e tyre konsiston ne procese si krasitja sipas sezoneve te duhura dhe ujitja ne menyre periodike.

Siperfaqe me shkurre: Ze nje siperfaqe prej 109 rrenje te cilat do te mirembahen sipas sezoneve te caktuara.

Fidanishte me dru e shkurre dhe farishe : Zen nje numer 1846 rrenje druresh e shkurresh dhe 105 m² farishte e cila do te kete qellim kryesor pergatitjen e farave, sip. e luleve shkurreve dhe te fidaneve per tub ere gati per mbjelljen e tyre per ne kete siperfaqe. Ketu

parashikohen te gjithë zerat si me larte: punetoria, materialet per lende te pare, mjetet e punes dhe transporti.


Siperfaqe rruge e sheshe: Ne kete siperfaqe 7478 m² duhet te dominoje sip. me bar, ku mund te nderthuren edhe sip. te tjera si: me shkurre, peme me gjatesi te objektit, duhet te ruhen te gjitha parametrat e larte permendur.

Vaditja me autobot: te sigurohet qe te mos kete nderprerje te ujit te rrjedhshem si dhe te mirembajtjes se mjetit per te mos nderprere vijueshmerine e punes. Te kihen parasysh zerat si me larte: Punetoria, materialet (si nafta, lubrifikantet), mirembajtja e makine, shpenzimet per uje.

Gjate zbatimit te punimeve dhe sherbimeve te gjelberimit duhet te kihet parasysh per njesite administrative te bashkise :

Siperfaqe me bar : Ze nje siperfaqe prej 16 685 m² te cilat perfshijne 6 njesi administrative (Dushk,Fiershegan,Bubullime ,Kolonje,Golem dhe Krutje).Pas mbirjes se barit duhet te kositet dhe te mirembahet ne menyre periodike.

Drure dekorative :Numri i drureve dekorative ka nje numer prej 1091 rrenje Mirembajtja e tyre konsiston ne procese si krasitja sipas sezoneve te duhura dhe ujitja ne menyre periodike.



TE TJERA

Mirembajtja dhe ruajtja e objekteve inerte dhe te lulishteve njesine Lushnje dhe njesite administrative:

Te gjithë objekte inerte si : shatervane ,monumenteve ,buste dhe stola brenda blloqeve te banimit dhe lulishteve.Pastrimi dhe ruajtja e tyre do te kryhet nga subjekti i firmes

Inventari i objekteve inerte mbartet vazhdimisht nga Bashkia sa here qe ai rritet nga investimet dhe shtimii i siperfaqeve te reja te cilat do te merren ne dorezim nga sipermarrrja.

Duhet te tregohet kujdes i vecante ne ruajtjen e siperfaqeve te gjelberta, te barit, te luleve, bimet qe jane te mbjellure ne keto siperfaqe si drure, shkurre etj si dhe te gjithë objekteve inerte stola shatervane, kosha te vegjel etj.

Per kete qellim do te organizohet sherbimi i ruajtjes me nje person pergjegjes material per cdo dite me orare te disfazuara dhe ne turnet e para te dyta dhe te treta sipas nevojave te dites dhe situatave qe paraqiten. Per cdo demtim subjekti fitues do te jete pergjegjes material te cdo demtimi te bimeve ose edhe te infrastruktures. Bimesia ne rastet e demtimit si druret dekorative rrugor , shkurret e lulet duhet te zevendesohet brenda 5 ditevembas demtimit ne te kundert subjekti do te jete pergjegjes material deri ne dorezimin e inventarit.

Sherbimi i ruajtjes

Personeli ruajtjes duhet te jete i veshur me uniforme i afte per riparime elektromekanike dhe do te jete pergjegjes material per demtimet e mundshme.

Organizimi i sherbimeve dhe i punimeve.

Sherbimet si pastrimi nga mbetjet dhe bari i keq ne siperfaqet inerte dhe ato te barit dhe luleve , mbetjet teknologjike nga krasitjet, prashitjet per te gjithë llojin e bimesise si siperfaqe me lule, drure dhe shkurre dekorative dhe bordurat e gjelberta, vaditjet ne siperfaqet ,me lule, siperfaqet me bar, druret e rinj, shkurret, mbjellja e fidaneve te rinj, etj si dhe gjithë sherbimet e tjera te paparashikuara e te domosdoshme nga me te ndryshmet qe evidentohen ne cdo rast dhe ne cdo dite **do te realizohen nga punetoret e perhershem e te palevizshem te cilat jane llogaritur ne pasqyren perkatese te evidentimit te sherbimeve dhe llogaritjen e numrit te nevojshem te punetoreve.**

Numri i punetoreve ruajtes e mirembajtes te perhershem dhe te punimeve llogaritet per cdo muaj dhe tregohet ne tabelat perkatese te planifikimit te sherbimeve dhe te punimeve per cdo sezon.


Pra si procese pune kryesore jane kositja e siperfaqeve te barit, krasitjet e drureve rrugor dhe neper lulishte, krasitja e shkurreve dhe pastrimi i mbetjeve, vadija dhe pastrimi i vazove te drureve rrugor, mbjellja e siperfaqeve me lule, bordurave te gjelberta dhe siperfaqet e barit per rinovim etj.

Punimet e kesaj natyre do te realizohen nga punetoret sezonale te nevojshem sipas organizimit qe do te beje subjekti fitues duke mos prekur numrin e tyre dhe frekuencave perkatese te punimeve.

Asnje person i subjektit apo i personelit punonjes te Bashkise nuk ka te drejte te beje reduktimin ose levizjen e punetoreve nga sherbimi ruajtjes-mirembajtjes te siperfaqeve te gjelberta.

Pagesat e punimeve te kryera. Situacionet.

Situacioni eshte nje element teknik dhe bazohet ne vleren e volumeve te punimeve sezonale dhe realizimin e frekuencave te pasqyruara me process verbalet perkatese te mbajtura ne cdo tre dite te firmuar nga te dy palet.



TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qellimi i sherbimeve

Per te ruajtur mjedisin dhe mbi te gjitha cilesine e ajrit eshte e domosdoshme ruajtja dhe zhvillimi I siperfaqeve te gjelberta.

Ne kushtet e rritjes se popullsise dhe te zhvillimit ekonomiko kulturor e ben te domosdoshme mirembajtjen dhe zhvillimin e dekorit ne fushen e gjelberimit.

Per ruajtjen, mirembajtjen dhe zhvillimin e gjelberimit te qytetit te Lushnjes dhe njesive administrative, Bashkia Lushnje ka hartuar projekt- detyren dhe do te kryeje prokurimin e fondeve perkatese te ketij sherbimi.

Detyrat:

Per realizimin e detyres se ketij projekti Bashkia Lushnje ka caktuar nje fond nepermjet te cilit do te kryeje nje volum punimesh te caktura dhe do te beje te mundur r ealizimin e detyres se caktuar, rritjen e dekorit ne siperfaqet e gjelberta dhe influence positive ne uljen sa me shume te ndotjes ne qytet.

Per kete aktivitet jane caktuar inventaret e siperfaqeve te gjelberta dhe volume e punes ne cdo ze punimi qe do te beje te mundur ruajtjen, mirembajtjen dhe zhvillimin e ketij aktiviteti.

Volume i punimeve te mirembajtjes dhe ruajtjes se siperfaqeve te gjelberta eshte ndare ne grupe te vecanta ne te cilat jane caktuar me zera te hollesishem te gjitha volume perkatese per cdo ze te sherbimit te mirembajtjes duke respektuar manualet teknuke dhe eksperiencen e punes se deritanishme.

Grupet e punimeve jane:

- a.** Sherbimet e pastrimit te siperfaqeve te gjelberta.
- b.** Sherbimet agroteknike te siperfaqeve te barit.
- c.** Sherbimet agroteknike ne siperfaqet e luleve.
- d.** Sherbimet agroteknike ne druret dekorative
- e.** Sherbimet agroteknike ne shkurret dekorative.
- f.** Sherbimet agroteknike ne bordurat e gjelberta
- g.** Sherbime per ruajtjen e te gjitha strukturave nga demtimet eventuale.

Shperndarja:

Kerkese kryesore ne aktivitetin e mirembajtjes,ruajtjes dhe zhvillimit te hapsirave te gjelberta eshte pastrimi ne siperfaqet inerte dhe te gjelberta, sherbimet agroteknike ne siperfaqet me lule, ne siperfaqet me bar, ne druret dekorative , ne shkurret dekorative, ne bordurat e gjelberta, ne kontrollin edhe marrjen ne dorezim te gjitha mbjelljeve ne te gjitha strukturat dhe zevendesimet ne siperfaqet me lule me fidane cilesore dhe venien ne pune te sistemeve vaditese ne te gjitha siperfaqet. Te gjitha punimet qe do te kryhen do te perfshihen ne inventaret perkates qe do ti aneksohet kontrates se siper marrjes.

Vendi dhe dorezimi i sherbimeve

Sherbimet do te kryhen ne te gjithe siperfaqen e percaktuar sipas preventivit dhe sipas inventarit. te hartuar .

Grupi i punes :

Ergest Krakulli

Juliana Hasalla

Irena Sinani

Fatma Hoxha

Elton Korroveshi

